

NACIONAL

Drejtore:
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com

Si u vranë gjyshi dhe babai i Ibrahim Rugovës

Rrustë Sadri Rugova, gjyshi i kryetarit të ndjerë të Kosovës, dr. Ibrahim Rugovës, ka qenë 67-vjeçar, kur është arrestuar në oborrin e shtëpisë së vet në Cerrcë...

faqe 15



Një ditë Shqipërie në Zvicër

Vijmë nga pjesa veriperëndimore e Zvicrës në verilindje vetëm për disa orë me tren, në vendin me infrastrukturën më të mirë në botë...

Reportazh nga Skënder Buçpapaj

faqe 2



JO TËRHEQJE E NXITUAR NGA KOSOVA

Nga Kristof Haselbah

"Kjo nuk duhet të bëhet me ngut. Ne nuk duhet të na merren këmbët pak para se të kemi arritur finishin..."

faqe 3

SFIDAT E UNIVERSITETEVE TONA

Nga Spasse Thanasi

Në kushtet e Shqipërisë, kur demokracia kërkon më shumë hapësirë, çelja e Univeristeteve të reja me degë e profesione më të përshtatshme me kohën, është një domosdoshmëri e pakapërcyeshme...

faqe 4

GAZETARIA SI ROJË PUBLIKE

Nga Nazmi Lukaj

"Publicistika e mirëfilltë duhet të jetë kujdesi i vetë botuesve, edhe për të mirën e saj, edhe për të mirën e gazetave të tyre, për të qenë ato në shërbim të një Kosove me perspektivë të sigurt."

faqe 4

RILINDJA E TROPOJËS SË VJETËR

Reportazh nga Mujë Buçpapaj

Shpend Hoxha po restauron këtë histori dhe krejt infrastrukturën e dukshme të komunës, me rrugë, shkollë, ujësjellës, internet etj.

faqe 5

HEROI SHQIPTAR I KRETËS

Nga Namik Selmani

Në qendër të Kretës në Greqi është ngritur prej shumë vitesh një bust i veçantë i një luftëtari të shquar...

faqe 15

SHQIPËRIA NË VERËN E VITIT 1939

Nga Johanna Jutta Neuman

"Kudo përgjatë plazhit të Durrësit kishte shtëpi të vogla të bukura verimi..."

faqe 19

Garderoba e heroit tonë kombëtar

Veshja e Skënderbeut

Nga mr. Bashkim Lajçi

faqe 10



Gjithçka rreth nobelistit Jose Saramago

Në BRENDËSI

"Pastrimi i sheshit"
Tregim nga Eqerem Basha

faqe 16

Në mungesë
Poezi nga Elida Buçpapaj

faqe 12-13

Komunikimi joverbal
Ese nga Gjekë Marinaj

faqe 9

Vitrash i thyer
Poezi nga Murteza Nura

faqe 8

Pas një interviste
Tregim nga Ferit Fixha

faqe 14

Baladë për UÇK-në
Poemë nga Ibrahim Gani

faqe 11

Prezantohet libri
Jahelzët e Dragobisë

faqe 17


Proza e Konstandin M. Lekës

Kritikë nga Bajazit Cahani

faqe 6

Poezi nga Jusuf Zenunaj
Sylë Mujaj
Kozeta Bulla


faqe 11



"Shtjella ujërash"

Poezi nga Federiko Garsia Lorka

faqe 6



Tragjikja e panjohur e gjenialëve shqiptarë

Nga mr. Sinan Gashi

faqe 21

Gjesticulacionet nënkuptojnë më shumë ndjenjat e personit

KOMUNIKIMI JOVERBAL DHE GJESTIKULACIONET

Deri diku gjestet janë pjesa verbale e mesazhit dhe shoqërohen nga simbole joverbale. Sipas këtij arsytimi, gjesticulacionet bëhen të rëndësishme në komunikimin joverbal, sepse ndihmojnë dëgjuesin në interpretimin e asaj që folësi nënkupton me të vërtetë me atë që thotë.

Nga Gjekë Marinaj

Komunikimi jo verbal shpesh mund të jetë më i kuptueshëm, se sa të shprehurit përmes gjuhës së folur. Një fjalë e urtë e vjetër thotë: “Gjestet flasin më shumë, sesa fjalët” e cila mbart më shumë të vërtetë, nga sa mund të perceptojnë njerëzit. Pa dyshim që njohja e kuptimit të gjesticulacioneve dhe prejardhja e tyre në kulturën tonë sapo kanë filluar të gjejnë zbatim në disa nga fushat e arteve të performuara dhe shkencave. Gjithsesi kjo njohje në asnjë mënyrë nuk përqendrohet në interpretimin e gjerë të materialit, duke i lënë të vetëm disa nga psikologët, antropologët dhe sociologët të paraqesin përfundimet e tyre shkencore, artistike e kulturore përmes studimeve të veçanta që flasin për komunikimin jo verbal dhe gjesticulacionet e natyrës njerëzore. Po të perifrazojmë Pol Ekman-in, as emocionet, as gjestet nuk janë nocione që mbështeten nga psikologët në mbarë botën. Fjala “gjest” nënkupton të vërtetën e asaj që thuhet. Disa psikologë nuk e pranojnë, se realisht kemi të bëjmë me një gjendje të veçantë organike që lidhet me konceptimin naiv për emocionet njerëzore, ndaj për rrjedhojë ky gjest është i palogjikshëm. Të tjerë mendojnë se veprimet që i përgjigjen kësaj fjale janë pjesë e reagimeve emocionale të organizuara dhe si përfundim “gjesti” përmbledh natyrën e veprimeve me më pak arsye, se sa po ta ilustronim si pjesë e reagimeve emocionale. Ndërsa sërish disa të tjerë mendojnë se gjesticulacionet funksionojnë së pari si pjesë e komunikimit dhe transmetojnë diçka rreth qëllimeve apo emocioneve të brendshme dhe nxjerrin vlera nga kuptimi i “gjestit”. Mbi të gjitha do t’ju them, se gjuha e trupit dhe kryesisht gjesticulacionet, mbeten një nga karakteristikat më të rëndësishme të komunikimit njerëzor.

Deri diku gjestet janë pjesa verbale e mesazhit dhe shoqërohen nga simbole jo verbale. Sipas këtij arsytimi gjesticulacionet bëhen të rëndësishme në komunikimin jo verbal, sepse ndihmojnë dëgjuesin në interpretimin e asaj që folësi nënkupton me të vërtetë me atë që thotë. Sikurse e përcakton Zivin: “Veprimet shprehëse janë pjesë përbërëse që në përgjithësi quhen “gjestë”. Këto përfshijnë veprime të kryera nga njerëzit të cilat interpretohen si konkluzione apo instinkte, duke transmetuar informacionin saktë apo gabim për gjendjen e brendshme të tyre. Për këtë arsye gjestet nënkuptojnë marrëdhëniet midis gjendjes së brendshme dhe veprimit që e shoqëron atë. Duke qenë se nënkuptimi i situatës është i diskutueshëm, termi për veprime të lexueshme, përdoret për t’u referuar atyre që shpesh herë paraqiten si situata të kuptueshme pa marrë parasysh se në të vërtetë ka të bëjë me gjendjen. Mirëpo kuptimi i kësaj gjendje nuk është i plotë” (Zivin, 5). Po të diskutonim nga e kundërta, rëndësia e gjesticulacioneve do të mbetej në të njëjtin pozicion. Ndoshta mund të keni dëgjuar dikë të thotë se, “Unë mund t’ua them, edhe kur dikush gënjen,” por diçka të tillë nuk mund ta thoni gjithmonë. Disa mund t’ju shohin drejt e në sy dhe t’ju gënjejnë pa fund. Kur thonë gënjeshtër, fillimisht duken shumë të sinqertë dhe të besueshëm sepse dinë si t’i fshehin emocionet.

Zakonisht të folurit me sy është një nga mënyrat për të shprehur sinqeritetin dhe pafajësinë. Nëse keni diçka të rëndësishme për të komunikuar, shikojeni dëgjuesin drejt e në sy me pastërti dhe pa e hequr shikimin në mënyrë që ta bindni t’ju dëgjojnë për atë që po i thoni. Ky është një lloj vëzhgimi për të kuptuar nëse dëgjuesit janë të vëmendshëm ndaj asaj që po thuhet. Gjithashtu “vëzhgimi dhe diferenca e largësisë nga sytë dhe trupi duket se është një nga format më të prekshme” (Sarles, 67). Ndoshta mund ta keni pyetur fëmijën me një ton zëri të matur, “Ti e bërë këtë?” dhe keni vënë re pamjen e fajtorit që i shfaqet në fytyrë, sa herë e kanë kuptuar gabimin për veprime të cilat nuk do të duhej

t’i kishin bërë. Kur ndonjëri prej tyre kërkon ta fshehtë atë që ka bërë, nis të flasë pa ju parë në sy. Zakonisht faji shprehet me uljen e syve apo hedhjen mënjatë të syve e cila shoqërohet me përkulje të kokës. Kjo vihet re më shumë tek fëmijët, se sa të rriturit që shoqërohet nga njëra anë me instinktet e fëmijëve dhe pafajësinë e tyre, kurse nga ana tjetër me njohjen e problemeve prej të rriturve. Kur takohesh me një mikun tënd në rrugë, shikoni se ai nuk po ju buzëqesh, ndaj mund ta pyesni: “Çfarë të ka ndodhur, sot?” nga e cila kuptoni se atij i ka ndodhur diçka e pazakontë. Përgjigja e tij është se ai ndihet mirë, por nga buzë e varura dhe të folurit me ngadalë, ndjejmë se është i mërziur. Sipas një “analize koherente ashtu sikurse thuhet edhe nga shumë psikologë është se, pamjet e trishtuara përbëjnë format më inferiore të pasqyrit të fytyrave qaramane, të cilat mund të vihen re tek bebët e porsalindura, por ndryshimet që dallohen midis këtyre dy gjesteve e kundërshtojnë këtë analizë, edhe pse të dyja lidhen me stresin” (Ekman, 165). Shpesh herë përdorim njërin prej tyre si në grafikun e rrugës, ku përmes cepave të buzëve shprehin ndjenjat. Nga një studim i tillë del më qartë se buzë e varura lidhen me fytyrën e cila në përgjithësi është e lodhur.

Por jo gjithmonë është kështu me buzëqeshjen. Në pjesën më të madhe të kohës, kur njerëzit janë të lumtur, kanë buzëqeshje në fytyrat e tyre. Dhëmbët zakonisht dalin dhe mollëzat ngrihen lart. Në përgjithësi buzëqeshja transmetohet nga njëri person tek tjetri. Nëse dikush ka kaluar një ditë të pakëndshme, një buzëqeshje mund t’ju ndihmojë për ta gjallëruar më shumë atë. Buzëqeshja



do të thotë se personi është i lumtur, apo i ngazëlyer për diçka që i ka ndodhur. Ajo të bën të ndihesh mirë dhe ju bën të ndjeheni edhe më mirë kur dikush ua kthen buzëqeshjen. Ndoshta mund të takoni një person vërtetë të lumtur ku nga buzëqeshja e madhe në fytyrën e tyre, duket gëzimi dhe lumturia, i cili ndjehet edhe në zërin e tyre. Kjo buzëqeshje është e sinqertë dhe frymëzuese. Në të kundërt, “në rastin kur ke turp, nëse dikush kalon para teje për t’ju folur, menjëherë ndërroni rrugë që të mos i flisni. Ai kalon nga e djathta, ndërsa ti nga e majta dhe të dy i buzëqeshni pa dëshirë njëri - tjetrit, të dy shkoni në rrugën tjetër në të njëjtën kohë, duke e bërë kalimin të pamundur dhe kështu vazhdojnë



Ne foto Gjeke Marinaj

mashtrimi dhe ndryshimi deri sa të rifillojë miqësia apo të nisë armiqësia, deri në grindje” (Safire, 262). Gjithashtu mund të jeni një nga kolegët që gjithmonë buzëqesh kur ajo të bën komplimentin për flokët apo veshjen, por nga buzët dhe sytë e ulur, kuptohet se nuk është kompliment i sinqertë dhe një buzëqeshje e tillë është mashtruese.

Biseda do të ishte e mërziutshme pa gjesticulacione. Personi që ju dëgjon nuk do t’ju kushtonte shumë rëndësi. Fjalët janë ato që rrisin shkallën e kënaqësisë, shqetësimin apo interesimit për atë që po thoni. Ndoshta jeni duke treguar një histori para disa njerëzve dhe në mbyllje të saj, njëri prej tyre ngre vetullat me dyshim dhe thotë: “Nuk e besoj atë që ka ndodhur.” Ata nuk shprehin vetëm habinë përmes fjalëve, por e tregojnë edhe me vetullat e ngritura lart. Diku e kam lexuar dhe më vjen keq që nuk kam pasur mundësi t’i besoj këtij informacioni: “Vetullat mbartin funksionin “shprehës”, përveç akumulimit të frikës” (nga burim i panjohur). Ky gjesticulacion “i çuditshëm” ilustron mendimin se, ashtu siç ka thënë edhe Pol Ekman, “Gjestet e mosbesimit janë kalimtare dhe të vështira për t’u kuptuar apo për t’u vënë re në çastet aktuale. Ato pak a shumë shfaqen gjithmonë si përgjigje e ndodhive të befasishme dhe nënkuptojnë mesazhe për ato situatat që ndodhin sa hap e mbyll sytë, për ato të jashtëzakonshme, ose tërheqëse” (Ekman, 44).

“Zëri i Nënës” është zëri që gjithë fëmijët dhe adoleshentët e kanë dëgjuar, aq sa ndonjëherë u ka tronditur jetën. Kjo zakonisht shoqërohet nga një pamje e ngrirë, vetulla të ngritura dhe flegra hunde të hapura. Disa prej fëmijëve binden menjëherë, qoftë edhe ata që nuk janë tuajt. Këtu ka diçka me vetullat dhe flegrat e hundës. Ata mendojnë se jeni gati t’i rrihni dhe rrinë si të ishin të ngrirë në mes të rrugës. Kur një person inatoset, gjesticulacioni merret më seriozisht nga marrësi i mesazhit, i cili pothuajse ka gjasa se do të ishte më i frenuar. Ndërkohë vetullat bëhen hark, buzët dalin para dhe sytë nuk tregojnë më njeriun e lumtur. Ky nuk është ai personi me të cilin do të mund të kaloje kohën atë ditë, deri sa t’i rikthehet gëzimi. Askush nuk do të donte të ishte me një njeri që qëndron i inatosur gjatë gjithë ditës. Po të përshkruajmë variantet e këtij rasti, nga njëra fytyrë në gjendjen normale drejt një fytyrë të inatosur, nuk do të ishte aspak përvojë e këndshme. “Ndërsa lidhur zakonisht me dhunën dhe shkatërrimin, ndoshta zemërimi do të ishte pa dyshim një emocion më ndërtesues, sikurse shpesh herë motivon përpjekjet e njerëzve për t’i drejtuar shqetësimeve nga padrejtësia e shtypja”. (cituar nga Bull, 135). Si përfundim, gjesticulacionet nënkuptojnë më shumë ndjenjat e personit. Ato janë pjesë e përdorimit të përditshëm. Njerëzit përdorin gjesticulacionet për t’iu bashkangjitur atyre që mendojnë apo ndjejnë. “Jo të gjitha veprimet me gjeste janë shumë shprehëse. Por ende i shërbejnë një qëllimi. Çdo grua mund t’i ketë vënë re gjestet e saj ndërsa vendos grimin në fytyrë, ose çdo burri mund t’i kujtohet pamja qesharake e fytyrës së tij ndërsa rruhet. Këto janë rrudha dhe plastika të qëllimshme që e bëjnë punën më të thjeshtë dhe të realizueshme” (Peck, 9). Na pëlqen, apo jo, ne përsëri e përdorim komunikimin jo verbal dhe gjesticulacionet. Mesazhet jo verbale kanë ndikim të fuqishëm tek perceptuesit sepse, “shpesh veprimet flasin më shumë, nga sa mund të thonë fjalët e folura. Kjo ndodh sepse përdorim simbolet jo verbale si mënyrë për të përcaktuar atë që mendon me të vërtetë dërguesi, si dhe shkallën e rëndësisë që na lidh me mesazhin” (Henson, Carol. Means, Thomas, Kapitulli 12).

Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji